# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE**
**PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026**

# UDHËZIM PËR VLERËSIM

**VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.**

**DETYRA 1**: Nxënësi/nxënësja* merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar numrin: ***2. joartistik***

**DETYRA 2**: Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse e ka përshkruar fjalën ***ju ftojmë***

**DETYRA 3**: Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka përshkruar se arsyeja e ftesës është ***hapja e ekspozitës***

**DETYRA 4**: Gjithsej ***2 pikë***

Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar se ***fton organizatori i ekspozitës / Ambasada e Finlandës në Beograd dhe QKU "Budo Tomoviq";***

Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar se *janë ftuar* ***publiku / fëmijët / vizitorët / populli dhe përgjigje të tjera të sakta.***

**DETYRA 5**: Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse përgjigjja tregon dallimin, përkatësisht se 9 tetori i referohet hapjes së ekspozitës, ndërsa data tjetër (9–17 tetor 2025) i referohet kohëzgjatjes së ekspozitës

**DETYRA 6:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar numrin: ***3. nga 9 deri më 17 tetor 2025***

**DETYRA 7:** Gjithsej ***2 pikë***
Nëse nxënësi ka përshkruar ose nënvizuar fjalët e shkruara saktë: ***pashmangësi*** dhe ***bashkëbisedim***.
Nxënësi merr ***1 pikë*** për një fjalë të përshkruar ose nënvizuar e cila është e shkruar saktë.

**DETYRA 8:** Gjithsej ***2 pikë***
Nëse nxënësi ka shkruar titullin e veprës: ***Burgu*** *dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj* ***Mehmet Kraja***.
Nxënësi merr ***1 pikë*** për titullin ose autorin e shkruar saktë.

**DETYRA 9:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar përgjigjen: ***2. një ëndërr***

---

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE**
**PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026**

**DETYRA 10:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar përgjigjen: ***3. theksuar idenë e izolimit***

**DETYRA 11:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar pohimet: **S, P, P, P.**

**DETYRA 12:** Gjithsej ***2 pikë***

Nëse nxënësi ka shkruar: ***Se ideja figurative e fjalës drejtoruc është zvogëlim apo diminutiv me nuancë përçmuese***.

Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigjen e saktë që përcakton formën zvogëluese të fjalës ose kuptimin përçmues të saj.

**DETYRA 13:** Gjithsej ***2 pikë***

Nëse nxënësi ka shkruar:

Figura stilistike e përdorur në dy vargjet e para është*:* ***eksklamacioni***

Strofa dhe rima e përdorur në strofën e parë është: ***katrena***, ndërsa rima ***ABAB*** ose ***kryq***

Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigjen e saktë ose për figurën stilistike ose për llojin e strofës dhe rimën e përdorur në strofën e parë.

**DETYRA 14:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar përgjigjen ***2. Mahnitje dhe admirim të thellë për bukurinë e natyrës.***

**DETYRA 15:** Gjithsej ***3 pikë***

Nëse nxënësi ka plotësuar tabelën:

| VARGJET | TITULLI I TEKSTIT | AUTORI |
|---|---|---|
| "Pres një shenj' e pres një dritë,<br>Pres me vjet' e pres me ditë,<br>Seç u treta, seç u mpaka,<br>Se u çora, seç u mplaka" | ***"Anës lumenjve"-*** | ***Fan Noli*** |
| "Përse të kam marrë grua?<br>Gratë për punë po janë." | ***"14 vjeç dhëndër"*** | ***A. Z. Çajupi*** |
| "Koha është të duhemi<br>të kesh besim në mua kur të them: Trime,<br>të kem besim në ty kur më thua: Trim" | ***"Dashuria"*** | ***Ali Podrimja*** |

Nxënësi merr nga ***1 pikë*** për plotësimin e saktë horizontal të një titulli të tekstit dhe autorit të tij.

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE**
**PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026**

**DETYRA 16:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar:

1. ***Lloji letrar epik (tregim i shkurtër)***;
2. ***Lloj letrar epik (Është një poemë epike me elemente dramatike)***;
3. ***Vepra i përket epikës (Është roman)***.

**DETYRA 17:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar përgjigjen: ***3 . rakursi***

**DETYRA 18:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka përcaktuar rasën e fjalëve:

veprat - ***rrjedhore***
fëmijërinë - ***kallëzore***
brezave - ***gjinore***

**DETYRA 19:** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar:

Botën shumëngjyrëshe të shpendëve e ndryshojnë çdo vit shpendët shtegtarë nga Evropa. Ajo është bota e ***saj***.

Të gjithë jemi të ftuar në ditëlindjen e ***saj***.

**DETYRA 20:** Skema e vlerësimit të hartimit ***Kam hasur në moskuptim.***
**Vërejtje: Hartimi lexohet edhe nëse është shkruar ose është filluar të shkruhet në vendin e parshikuar për planin e hartimit.**

| |
|---|
| **Përmbajtja – 10 pikë**<br><br>**Kërkesa 1.**<br>Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan se çfarë do të thotë për të mirëkuptimi ndërmjet bashkëmoshatarëve, ose ndërmjet të rriturve dhe fëmijëve, ose ndërmjet prindërve dhe fëmijëve dhe të ngjashme.<br><br>Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.<br>**Gjithsej 2 pikë**<br><br>**Kërkesa 2.**<br>Nxënësi merr 1 pikë nëse numëron disa nga tiparet e tij ose nëse shkruan për një dhe/ose më shumë prej tipareve të tij.<br><br>**Gjithsej 1 pikë**<br><br>**Kërkesa 3.**<br>Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për një situatë në të cilën ka hasur në keqkuptim. |

Nëse shkruan më në detaje për situatën, merr 2 pikë.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 3 pikë.

**Gjithsej 3 pikë**

**Kërkesa 4.**
Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për ndjenjat dhe mendimet e tij në lidhje me atë situatë.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

**Gjithsej 2 pikë**

**Kërkesa 5.**
Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt se përse është e rëndësishme të dëgjojmë dhe të kuptojmë të tjerët.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

**Gjithsej 2 pikë**

**Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura e tekstit** |
|---|---|---|---|
| → të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur<br><br>***2 pikë***<br><br>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve | GRAMATIKA<br>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës)<br>***2 pikë***<br><br>DREJTSHKRIMI<br><br>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe | → renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij<br>***1 pikë***<br><br>→ s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij<br>**0 pikë** | → përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike<br><br>***1 pikë*** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **pjesërisht e saktë**<br><br>***1 pikë*** | për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)<br><br>***2 pikë***<br><br>***Gjithsej 4 pikë***<br>GRAMATIKA<br><br>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)<br><br>**pjesërisht e saktë**<br>***- 1 pikë***<br>DREJTSHKRIMI<br><br>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)<br>**pjesërisht e saktë**<br>***- 1 pikë***<br>***Gjithsej 2 pikë*** | | |